



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 66 Prot.

Tiranë, më 11/01/2022

**V E N D I M**

**Nr. 11\_, Datë 11/01/2022**

Bazuar në nenin 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O N:**

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar ankesën nr.30 Regj, datë 26.02.2021, të paraqitur nga ankuese L.Gj, kundër Bashkisë Kukës, me pretendimin për diskriminim për shkak të “gjinisë” dhe “bindjeve politike”. Me vendimin nr. 143, datë 05.08.2021, Komisioneri ka disponuar në lidhje me ankesën, duke vendosur:

*“Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses L.Gj, për shkak të gjinisë dhe bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Kukës, në lidhje me uljen në pagë.*

*Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit, të ankueses L.Gj, në të drejtën për punësim, nga ana e Bashkisë Kukës.*

*Në referim të pikës 1, Bashkia Kukës, të marrë masa për shfuqizimin e vendimit nr.37, datë 29.03.2021, të Kryetarit të Bashkisë “Për dhënien e masës disiplinore” ndaj ankueses.*

*Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Bashkia Kukës, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.*

*Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.*

*Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.”*

Rezulton e provuar nga lajmërim marrja e shërbimit postar se, Bashkia Kukës ka marrë dijani për vendimin në datën 06.08.2021

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Bazuar në nenin 33, pika 11, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet se : “Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa.”

Rezulton e provuar se, Bashkia Kukës, në cilësinë e subjektit të gjetur përgjegjës për sjelljen diskriminuese, nuk e ka njoftuar Komisionerin brenda afatit 30 ditor të përcaktuar nga neni 33/11, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar në lidhje me masat e marra për zbatimin e këtij vendimit.

Me shkresën nr.759/3 prot., datë 03.12.2021, Komisioneri ka kërkuar informacion nga Bashkia Kukës në lidhje me zbatimin e vendimit nr.143, datë 05.08.2021. Rezulton e provuar nga lajmërim marrja e lëshuar nga shërbimi postar se, Bashkia Kukës ka marrë dijeni për këtë shkresë në datën 07.12.2021, por nuk ktheu asnjë përgjigje.

Bashkia Kukës, si subjekt i cili është gjetur përgjegjës për sjelljen diskriminuese nuk ka informuar dhe nuk ka zbatuar vendimin e Komisionerit. Në këtë mënyrë Bashkia Kukës nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 32/11, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Ky mosveprim, kjo mospërmbushje e këtij detyrimi ligjor, në bazë të nenit 33/13, të ligjit të sipërpërmendur shoqërohet me marrjen e masave administrative, gjobë. Për personat juridik, siç është në rastin konkret Bashkia Kukës, ky nen përcakton shkrehimisht: “Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë”:..... b) personi juridik nga 60.000 deri në 600.000 lekë;.....”

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi arrin në konkluzionin se, Bashkia Kukës, është në shkelje të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 32/11, të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, shkelje e cila sipas nenit 33/13, të po këtij ligji është e dënueshme me gjobë.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 32, pika 1, gërma “ç”, 33, pika 11, 33 pika13, germa “b”, si dhe 33/1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Bashkia Kukës, të gjobitet në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë.
2. Gjoha të paguhet në Buxhetin e Shtetit brenda 45 ( dyzetë e pesë) ditëve nga marrja dijeni.

3. Pagesa e gjobës të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 001, Distrikti (TDO) 3535, Llogaria ekonomike: 7115499.
4. Zbatimi i vendimit nr.143, datë 05.08.2021, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, sjell shfuqizimin e gjobës.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**